

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE GJAKOVË/DEGA MALISHEVË-Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal,** Gjyqtari i vetëm gjykues Njazi Morina, me zyrtaren ligjore Alban Morina, në lëndën penale kundër të akuzuarit A. B. nga fshati B., Komuna e M., për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP.nr.405/15, të datës 25.08.2015, në shqyrtimin fillestar publik, të mbajtur më datën 14.12.2018, në prani të prokurorit të shtetit Ramiz Buzhala, të akuzuarit, A. B., më datën 18.12.2018 mori dhe publikisht shpalli këtë:

## AKTGJYKIM

I akuzuari A. B., i biri i H. dhe i ëmës N., e gjinisë Sh., i lindur më datën ....., në fshatin B., Komuna e Malishevës ku dhe tani banon, shqiptar, shtetas i R. së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së dobët ekonomike, punëtorë.

## Ë shtë fajtor:

Për shkak se:

Ndërmjet datës së pavërtetuar e gjer me dt.29.10.2014, në shtëpinë e tij në fshatin B., Komuna e Malishevës, me qëllim që ti sjell vetit pasuri në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar në mënyrë të paautorizuar energjinë elektrike, të konsumatorit gjatë kontrollit është konstatuar se jashtë njehsorit elektrik me nr....., përmes kabllot të cilin e ka futur nën çati, është lidhur direkt në rrjetin elektrik, me çka ka anashkaluar dhe penguar regjistrimin e energjisë elektrike të shpenzuar, gjendje kjo e konstatuar nga komisioni profesional i kalibrimit K.-Divizioni i rrjetit në P. me dt.29.10.2014, më çka të dëmtuarës i ka shkaktuar dëm në vlerë prej ... €.

-me çka ka kryer veprën penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 pra.1, të KPRK-së.

Gjykata në bazë të nenit 4,41,49,50,51, 52 par. 5,73, dhe nenit 320 par.1, të KPRK-së, dhe nenit 365 të KPPK-së i shqipton :

## **DËNIMIN ME KUSHT**

Dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve, dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

E dëmtuara: K. -Distrikti në Gj., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 Euro, në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, ka ngritë aktakuzën PP.nr.405/15, të datës 25.08.2015, kundër të akuzuarit A. B. nga fshati B., Komuna e Malishevës, për shkak të veprës penale vjedhje e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1, të KPRK-së, dhe ka propozuar që të akuzuarin ta shpallë fajtor, të dënohet sipas ligjit dhe të obligohet në kompensimin e shpenzimeve gjyqësore.

Prokurori i shtetit Ramiz Buzhala, në fjalën përfundimtare deklaron se pranimi i fajësisë mbështetet në provat që gjinden në shkresat e lëndës, dhe meqenëse i akuzuari e pranoj fajësinë, me rastin e shqiptimit të dënimit gjykata ti ketë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, dhe i akuzuari të shpallët fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

I akuzuari A. B. në fjalën e tij përfundimtare deklarohet i fajshëm, jam penduar për veprën e kryer, dhe është e vërtetë së gjatë kontrollimit të K.-it, mirëpo unë e komë lajmërua dy ditë më parë zyrtarin e K.-it, për me lidh orën elektrike, ky ka qenë rasti im i parë që kamë ra ndesh më ligjin dhe në të njëjtën kohë i premtoj gjykatës që asnjëherë të mos bije ndesh me ligjin.

Pasi Gjykata ka fituar bindjen se i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë për vepër penale, që i vihet në barrë dhe është i bindur se pranimin e ka bërë në bazë vullnetare, duke u mbështetur edhe në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, ka gjetur se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore nga neni 248 të KPPK-së, shqyrtimin fillestar e ka vazhduar me fjalën përfundimtare të palëve.

Me faktet e ofruara, me provat që gjenden në shkresat e lëndës siç janë: K., Procesverbal, nr....., i dt.29.10.2014; fotot e orës elektrike dt.29.10.2014; K., fatura nr. D., e dt.03.11.2014; Faturë, sektori i kthimit humbjeve .... e K.-it dt.31.10.2014, e sidomos me pranimin e fajësisë nga i akuzuari, është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, andaj me veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale vjedhje

e shërbimeve komunale nga neni 320 par.1, të KPRK-së, për të cilën vepër i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

Me rastin e matjes së dënimit, Gjykata i ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si rrethanë lehtësuese, Gjykata ka marrë parasysh pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga i akuzuari, i gjendjes së dobët ekonomike, është mbajtës i ... anëtar të familjes, asnjëri përjashtim të ti nuk punon, sidomos për faktin se është hera e parë që ndeshet me ligjin mos ndëshkueshmëria e tij e më parshme, të gjitha këto rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 73 të KPRK-së, Gjykata të akuzuarit i shqiptoi dënim me burgim në kohëzgjatje prej tre (3) muajve dhe dënim me gjobë në shumën prej njëqind (100) euro, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i akuzuari brenda kohës së verifikimit në afatin prej një (1) viti, nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Vendimi për udhëzimin e palës së dëmtuar në kontest civil, për realizim e kërkesës pasurore juridike, është marrë bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale në emër të paushallit gjyqësor, është marr konform nenit 450 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.6, lidhur me nenin 453 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendosë si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË/DEGA MALISHEVË**  
**P.nr.355/15, më datën 18.12.2018**

**Zyrtarja ligjore:**  
**Albane Morina**

**Gjyqtari i vetëm gjykues:**  
**Njazi MORINA**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit të aktgjykimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmes të kësaj Gjykate.